



2646
19313

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 2666 / Prot.

Tiranë, më 09.03.2026

Lënda: Kthim përgjigje.

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë.

RES PUBLICA

Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 2, Tiranë.

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së është administruar me nr. 2666 prot., datë 24.02.2026, shkresa juaj nr. 516/1 prot., datë 19.02.2026, nëpërmjet së cilës pëcillet kërkesa për informacion e Qendrës "Res Publica".

Referuar parashtrime kërkohen të dhëna statistikore lidhur me ndërtimet informale të legalizuara gjatë vitit 2025, të ndara sipas qyteteve dhe sipas kategorisë së ndërtimit (shitesë ose ndërtim i ri), si dhe numri i aplikimeve për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje që janë ende në proces.

Në lidhje me kërkesën për informacion mbi numrin e ndërtimeve të legalizuara gjatë vitit 2025, ju bëjmë më dije se:

Drejtoritë vendore të ASHK-së, për periudhën Janar – Dhjetor 2025, kanë trajtuar 28574 praktika legalizimi, nga të cilat është konkluduar me vendimmarrje përfundimtare në zbatim të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë", VKM nr. 1040/2020 "Për përcaktimin e rregullave të zbatimit...", i ndryshuar dhe VKM nr. 1178/2020 "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, për 26101 praktika legalizimi.

Ndërsa për 2473 praktika legalizimi është vendosur pezullimi e procedurave administrative në zbatim të Nenit 27, 28 dhe 29 të ligjit 20/2020, si dhe në zbatim të përcaktimeve të VKM nr. 1178/2020.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat e legalizimeve sipas drejtorive vendore.

DREJTORIA VENDORE E ASHK-SË	VENDIME PËRFUNDIMTARE	VENDIME TË NDËRMJETME / PEZULLIME
BERAT	1075	68
DIBËR	544	402
DURRËS-KAVAJË-KRUJË	3034	0

ELBASAN	1847	0
FIER	1102	26
GJIROKASTËR	603	169
KAMËZ VORË	1723	120
KORÇË	917	235
KUKËS	591	298
LEZHË	874	0
LUSHNJE	1419	33
POGRADEC	792	562
SARANDË	692	62
SHKODËR	1758	2
TIRANA VERI	2416	203
TIRANA JUG	1783	112
TIRANA RURALE 1	1853	24
TIRANA RURALE 2	1870	11
VLORË	908	0
ZONAT E STIMULUARA	300	146
TOTALI	26101	2473

Theksojmë se numri i objekteve të deklaruara për legalizim nuk mund të evidentohet saktësisht pasi procesi i vetëdeklarimit për ndërtimet informale është hapur disa herë me ligjet përkatëse, për rrjedhojë për një të njëjtin objekt mund të ketë disa aplikime.

Përsa i përket ankimit të Qendrës “Res Publica”, se nuk ka marrë përgjigje mbi kërkesën në format elektronik drejtuar koordinatorit për të drejtën e informimit pranë ASHK, ju sqarojmë se pranë, emaili i subjektit është drejtuar në adresën elektronike informacion@ashk.gov.al, e cila është një adresë e cila nuk është funksionale, ndërsa adresa e saktë për të kërkuar informacion është info@ashk.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Lorena GOXHOBELLI

